



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2024

PËR

**“DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 16/2018 “PËR DIASPORËN”,
I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 16/2018, “Për Diasporën”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1
Objekti

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e parimeve dhe rregullave për:

1. Ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës dhe lidhshmërinë e tyre me institucionet shtetërore në vendin e origjinës;
2. Funksionimin dhe ndërveprimin midis organeve shtetërore dhe autoriteteve publike;
3. Zbatimin e politikave dhe strategjisë për “Diasporën Shqiptare” në nivel qendror dhe lokal si dhe informimin;
4. Kompetencat e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën.”

Neni 2

Në nenin 2, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 shfuqizohet.
2. Pika 3 zhvendoset dhe bëhet pika 1.

Neni 3

Pas nenit 2, në titullin e Kreut II, fjala “shtetërore” shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 3, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titull dhe në fjalinë e parë, fjala “shtetërore” shfuqizohet.
2. Pikat 2 dhe 8 shfuqizohen.
3. Në pikën 4, fjala “...Koordinativ...” zëvendësohet me fjalën “...Koordinues...”.
4. Në pikën 6, pas fjalës “... studimeve ...” shtohen fjalët “... dhe Publikimeve ...”.
5. Në pikën 10, pas fjalës “... shtetërore ...” shtohen fjalët “... entiteteve publike ...”.

Neni 5

Neni 4/1 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 5 bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në shkronjën “b”, në krye të fjalisë shtohet fjala “Harton ...”.
2. Shkronja “e” shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3, 4 dhe 7 ndryshohen si më poshtë:
 - “3. Kreu i QKD-së emërohet dhe lirohet me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe është në varësi të Kreut të Misionit Diplomatik. Gjatë kohës së shërbimit në misionin diplomatik, Kreu i QKD-së gëzon statusin e diplomatit.
 4. QKD-ja ushtron funksionet në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe detyrime të tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e QKD-së rregullohen sipas dispozitave në fuqi të Kodit të Punës.

7. Struktura dhe organika e QKD-së miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme”.
2. Pikat 5 dhe 8 shfuqizohen.

Neni 8

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “c” ndryshohet me këtë përmbajtje:
“c) Të nxitë bashkëpunimin ekonomik, shkencor, teknologjik, kulturor, arsimor, sportiv, ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës.”
2. Në pikën 1, shkronja “ç” shfuqizohet.
3. Në pikën 2, togfjalëshi “...ministri përgjegjës për diasporën...”, zëvendësohet me togfjalëshin “ministri përgjegjës për punët e jashtme...”.

Neni 9

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:
 - “1. Këshilli i Ministrave ndihmon në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhës shqipe, si edhe në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e arbërishtes.
 2. Ministri përgjegjës për diasporën, së bashku me ministrin përgjegjës për arsimin, ndihmon dhe përkrah zhvillimin e procesit mësimor të gjuhës shqipe në vendet ku ka një numër të madh pjesëtarësh të diasporës.”
2. Në pikën 5, togfjalëshi “...Ministrinë përgjegjëse...” zëvendësohet me togfjalëshin “...ministrin përgjegjës...”.
3. Në pikën 6, togfjalëshi “...Ministrinë përgjegjëse...” zëvendësohet me togfjalëshin “...ministrin përgjegjës...” dhe fjalët “... internetit (programe telefoni ose tabelë) dhe rrjeteve e...” shfuqizohen.

Neni 10

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4 togfjalëshi “...Ministrinë përgjegjëse...” zëvendësohet me togfjalëshin “...ministrin përgjegjës...” dhe fjala “...eventeve...” zëvendësohet me fjalën “...aktiviteteve...”.

Neni 11

Në nenin 12 togfjalëshi "...Ministrinë përgjegjëse..." zëvendësohet me togfjalëshin "...ministrin përgjegjës...".

Neni 12

Në nenin 13, pika 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

- "1. Radiotelevizioni Shqiptar siguron kanal transmetimi me program radioteleviziv dedikuar Diasporës."

Neni 13

Në nenin 14, titulli ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14
Bashkëpunimi ekonomik dhe shkencor".

Neni 14

Në nenin 15, pika 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

- "1. Për pjesëtarët e suksesshëm të diasporës akordohen çmime."

Neni 15

Në nenin 18, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:
 - "1. Këshilli Koordinues i Diasporës (Këshilli) përfaqëson, bashkëpunon dhe koordinon marrëdhëniet me diasporën përfshirë organizatat e diasporës."
2. Në pikën 2, shkronja "a", fjala "...veprime..." zëvendësohet me fjalën "...sugjerime..." dhe fjala "...përcakton..." zëvendësohet me fjalën "...sugjeron..."
3. Në pikën 2 shtohen paragrafët "c" dhe "ç" me këtë përmbajtje:
 - "c) Bashkëpunon me organet përkatëse për Organizimin e Samitit të Diasporës.
 - ç) Këshilli Koordinues i Diasporës identifikon, trajton, dhe propozon çështje dhe projekte me natyrë ekonomike, ligjore, kulturore, shkencore e sportive për diasporën".
4. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:
 - "3. Anëtarët e Këshillit mbajnë kontakte, organizojnë aktivitete me komunitetet shqiptare në shtetet që përfaqësojnë, në varësi të agjendave të planifikuara nga kryesia e Këshillit."
5. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 16

Në nenin 19, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 numri “...15...” zëvendësohet me fjalët “...jo më pak se 21...”.
2. Në pikën 2 fjalët “Agjencia Kombëtare e Diasporës” shfuqizohen.
3. Pika 3 bëhet pika 4 e nenit 21.

Neni 17

Në nenin 20, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:
“2. Përfaqësuesit e Këshillit për zgjidhen nga shtetet ku jeton komuniteti shqiptar.”
2. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 18

Në nenin 21, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

- “4. Presidenti i Republikës, me kërkesën e tij dhe në koordinim me Kryeministrin dhe ministrin përgjegjës për diasporën, merr drejtimin e mbledhjeve të veçanta të Këshillit Koordinues të Diasporës.”

Neni 18

Neni 22 shfuqizohet.

Neni 19

Pas nenit 21, shtohet neni 22 me këtë përmbajtje:

“Neni 22
Agjencia Kombëtare e Diasporës

Agjencia Kombëtare e Diasporës krijohet si institucion varësie për të kryer funksione të përcaktuara brenda fushës së përgjegjësisë së përgjithshme shtetërore të ministrit përgjegjës për diasporën. Krijimi, misioni, funksionet dhe organizimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 20

Në nenin 23, pika 1, togfjalëshi “... Ministrit përgjegjës për diasporën” zëvendësohet me togfjalëshin “... ministrit përgjegjës për arsimin”.

Neni 21

Neni 26 shfuqizohet.

Neni 22

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e aktit nënligjor, në zbatim të nenit 22, të këtij ligji.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA